



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1020 Prot.

Tiranë, më datë 09.11.2020

VENDIM

Nr. 382, datë 06.11.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.11.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor në vazhdim të ri **Shqiptaro – Zviceran, “Lin 3” bashkëpunim i Institutit Arkeologjik të Tiranës (ASA), dhe Instituti i Shkencave Arkeologjike të Universitetit të Bernës** drejtuar nga Prof. Dr. Albert HAFNER dhe Dr. Ariane BALLMER (Instituti i Shkencave Arkeologjike, Universiteti i Bernës) për palën zvicerane dhe Prof. Dr. Ilirjan GJIPALI dhe Dr. Adrian ANASTASI (Instituti Arkeologjik i Tiranës) për palën shqiptare, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Qasja metodologjike në sit:

- Inspektimi i sipërfaqes, vlerësimi i terrenit;
- Korrigjimi i sedimentit;
- Gërmim arkeologjik nëpërmjet sondazheve;
- Marrja e mostrave të materialit nëpërmjet karrotazheve.

Qëllimet shkencore:

- Shtrirja e sitit;
 - Kronologjia e sitit (stratigrafia dhe datimi absolut);
 - Arkeologjia e sitit (arkitektura, kultura materiale);
 - Ekonomia e ekzistencës (mbetjet ushqimore, mbetjet e blegtorisë dhe kultivimi i bimëve);
 - Paleo mjedisi (historia e bimësisë dhe klima).
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brënda vitit 2020;
 3. Në rastet kur parashikohen ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre, dhe të shoqërohen me projekt konsolidimi/konservimi/restaurimi pranë IKTK;
 4. Të depozitohen pranë IKTK-së, DRTK-së dhe IKRTK-së lista e inventarit të gjetjeve me qëllim grumbullimin, informimin/ regjistrimin sipas rastit dhe ekspozimin e tyre në Muze;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
 6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Arta DOLLANI